



SUPPORT
TO SOCIAL
PARTNERS



STUDIM MBI PAGËN MINIMALE

IDENTIFIKIMI I MODELIT MË TË MIRË PËR
KOSOVËN

MODELET E PRAKTIKAVE TË MIRA NË
PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE

Dokumenti i politikave u hartua për
Këshillin Ekonomik Social



An EU funded project managed by the
European Union Office in Kosovo

Ky vlerësim u përgatit nga Strategy & Development Consulting dhe u porosit nga 'Projekti i Mbështetjes së Partnerëve Socialë' i implementuar nga një konsorcium organizatash nën udhëheqjen e Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS) dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë.

Shënim

Ky publikim u realizua me mbështetjen e Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e plotë e Iniciativës Kosovare për Stabilitet dhe assesi nuk pasqyron qëndrimet e Bashkimit Europian.

Të gjitha të drejtat e rezervuara ©

qershor, 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	1
PAGA MINIMALE: ELEMENTET KYÇE.....	4
Avantazhet dhe disavantazhet e futjes së pagës minimale.....	4
Në cilat rrethana është e domosdoshme paga minimale?	7
Standardet e ILO-s për futjen dhe fuqizimin e pagës minimale.....	15
PAGA MINIMALE NË KOSOVË.....	20
Dispozitat ligjore.....	20
PAGA MINIMALE NË KOSOVË NË KONTEKST.....	23
RREGULLIMET E PAGËS MINIMALE: PARTNERËT SOCIALË.....	31
REKOMANDIMET	34
REFERENCAT	43
SHTOJCA.....	46

SHKURTESAT

BSPK: Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës

CPI: Indeksi i Çmimit të Konsumatorit

BE: Bashkimi European

ILO: Organizata Ndërkombëtare e Punës

FMN: Fondi Monetar Ndërkombëtar

ASK: Agjencia Statistikore e Kosovës

KIESA: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

UÇK: Ushtria Çlirimtare e Kosovës

AFP: Anketa e Fuqisë Punëtore

MPMS: Ministria e Punës dhe Mirëqënies Sociale

NACE: Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike në Komisionin European

OECD: Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PPS: Standardi i Fuqisë Blerëse

KES: Këshilli Ekonomik Social

ATK: Administrata Tatimore e Kosovës

UNDP: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësohen metodologjitë dhe praktikatat të cilat përdoren për të caktuar pagën minimale si dhe indikatorët të cilët duhet të merren parasysh me qëllim të informimit të procesit dhe të dialogut ndërmjet hisedarëve në Kosovë për përcaktimin e pagës minimale. Studimi assesi nuk synon të rekomandojë nivel a metodë të caktuar për vendosjen e pagës minimale, meqë kjo mund të jetë vetëm produkt i dialogut ndërmjet hisedarëve. Qëllimi kryesor është të ilustrohen aspektet kyçe të cilat duhet marrë parasysh kur lëvizet drejt përzgjedhjes së metodologjisë, si dhe të theksohet politika e gjithëmbarshme si dhe implikimet socio-ekonomike të ndryshimeve eventuale të politikave në kontekstin e Kosovës.

Paga minimale është komponentë thelbësore e sistemit të mbrojtjes sociale të një vendi, që synon të zbusë papunsinë dhe të rrisë drejtësinë sociale. Studimet tregojnë se në shumë vende pagat minimale kanë qenë efikase, ndër tjerash, edhe sa i përket zvogëlimit të pabarazisë në të ardhura, zbutjes së varfërisë, zvogëlimit të shpenzimeve qeveritare që kanë të bëjnë me beneficione sociale, si dhe forcimit të stabilitetit social. Në anën tjetër, studimet gjithashtu tregojnë se pagat minimale mund t'i ulin nivelet e punësimit dhe t'i nxisin punëtorët drejt informalitetit, derisa pagat më të larta minimale gjithashtu mund ta zvogëlojnë konkureshmërinë e sektorit privat.

Shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor e kanë përcaktuar pagën minimale në nivelin 40-50% të pagës mesatare. Në vitin 2011, Kosova ka caktuar pagën minimale prej 170 euro (bruto), me një pagë të zvogëluar minmale prej 130 euro për punëtorët nën moshën 35-vjeçare. Nuk ka dëshmi e cila flet për formulën e përdorur për të vendosur për këtë pagë minmale. FMN-ja në vitin 2013 ka vlerësuar se kriteret nuk janë vendosur në mënyrë koncize, dhe se nevojitet trajtim më i bazuar në rregulla, e kjo çoi

në nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për kriteret dhe vendosjen e procedurës për paga minimale. Këtë UA e ka nxjerrë MPMS-ja. Ky UA thotë se metodologjia për përlogaritjen e pagës minimale mund të rishikohet çdo tre vjet.

Nuk ekziston një mënyrë uniforme apo më e mirë për përcaktimin e pagës minimale. Vendet në Ballkanin Perëndimor dhe në BE përdorin kriteret dhe qasje të ndryshme. Faktorët siç janë rezultatet e tregut të punës, produktiviteti e shpërndarja e pagës janë disa prej elementeve më të rëndësishme ekonomike të cilat merren parasysh, derisa ndër kriteret e standardeve sociale/të jetesës, vendet rëndom parashohin nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, CPI-në (ndryshimin e standardit të jetesës), shkallën e inflacionit, të ardhurat nga beneficionet e sigurimit social, dhe krahasimet me standardet e grupeve të tjera. Vendet e ndryshme i japin peshë të ndryshme kriterëve, dhe kështu metodologjia është produkt i dialogut ndërmjet hisedarëve.

Aktualisht, ekziston mospajtimi ndërmjet partnerëve socialë dhe shoqatave biznesore në Kosovë sa i përket rritjes së pagës minimale, ku të parët konsiderojnë se paga minimale nuk është pagë e jetesës e cila i plotëson nevojat elementare të një familjeje mesatare të një punëtori, derisa të dytët theksojnë se një rritje potenciale do ta dëmtonte konkureshmërinë e sektorit privat.

Kush do të ndikohej nga ndryshimi i pagës minimale në Kosovë? Klasifikimi i të dhënave sipas aktivitetit ekonomik lë të kuptohet se pagat minimale kanë më shumë gjasa t'i prekin sektorët në vijim: bujqësinë, aktivitetet e shërbimeve të tjera, hotelierinë dhe akomodimin, si dhe sektorin e patundshmërive dhe të qiradhënies. Paga minimale gjithashtu ndikon në shpënzimet buxhetore meqë ajo është e lidhur ngushtë me skemën e pensioneve të veteranëve të UÇK-së, e cila është skema e vetme e cila është e caktuar në bazë të pagës minimale. Andaj, çdo vendim për

rregullimin e kësaj page duhet të marrë parasysh implikimet buxhetore për këtë skemë, duke pasur parasysh se numri i përfituesve pritet të jetë i lartë (numri i fundit i raportuar ishte 46,230 përfitues!).

Në procesin e zhvillimit të dialogut për vendosjen e metodologjisë për përcaktimin e nivelit të pagës minimale, në këtë studim shohim se hisedarët duhet të sigurojnë disponueshmërinë e të dhënave të besueshme në lidhje me indikatorët kyçë për ta ushqyer formulën për përlogaritje. Në këtë aspekt, është thelbësore të definohet paga e saktë minimale e jetesës, si dhe paga mesatare aktuale, gjë që përpiqemi ta bëjmë në këtë studim duke u bazuar në të dhënat dhe supozimet ekzistuese. Për më tepër, është thelbësore të vlerësohet ndikimi i pagës së propozuar minimale në kostot e punës, pagën minimale, shpërndarjen, si dhe realizueshmërinë e implementimit. Duke u bazuar në dialogun ndërmjet hisedarëve, metodologjia duhet përfundimisht ta specifikojë çdo kriter tjetër relevant për caktimin e pagës minimale si dhe ta specifikojë peshën e tyre, duke sajuar njëkohësisht formulën dhe shpeshtësinë për ndryshimin e saj. Ajo gjithashtu duhet të sigurojë se të gjitha efektet e tjera anësore merren parasysh, duke përfshirë koston e skemës së veteranëve të luftës, për të cilën në fund të këtij studimi kemi realizuar një simulim të bazuar në supozimet aktuale.

PAGA MINIMALE: ELEMENTET KYÇE

Avantazhet dhe disavantazhet e futjes së pagës minimale

ILO-ja e definojnë pagën minimale si: "pagë e cila përbën cepin e strukturës së pagës me qëllim të mbrojtjes së punëtorëve të cilët zënë pozitën më të ulët në shpërndarjen e pagës" (ILO, 2012). Nocioni "cepi dinjitoz i pagës" rëndom lidhet me pagën minimale, duke lënë të kuptohet se ajo duhet të lidhet me standardin [minimal] të jetesës por edhe se duhet të jetë mjaft e ulët për të mbetur në cep të shpërndarjes së pagës. Si e tillë, paga minimale duhet të jetë vetëm njëra prej komponenteve të sistemit të mbrojtjes sociale që synon zbutjen e varfërisë dhe përmbush nevojat e përfituesve të pagës dhe të familjeve të tyre, siç thuhet në Nenin 1 të Rekomandimeve për Caktimin e Pagës Minimale, ILO R135 1970¹.

Duke pasur parasysh se ajo përdor standardet e jetesës si bazë, paga minimale konsiderohet se i kontribuon zbutjes së varfërisë dhe drejtësisë sociale duke i përmirësuar jetët e grave dhe të burrave që punojnë me paga të ulëta (ILO, 2012). Dëshmitë nga një sërë vendesh anembanë botës e mbështesin këtë argument. Për shembull, studimet për Brazilin tregojnë se bashkë me Bolsa Familia (program i beneficionit familjar), paga minimale i ka ndihmuar zbutjen së varfërisë. Në Republikën Jugafrikane, paga minimale ka

¹ Qëllimi i Rekomandimeve për Caktimin e Pagës Minimale, ILO R135 1970 sa i përket Vendosjes së Pagës Minimale me Referencë të Posaçme në Vendet në Zhvillim ishte të parashihen kriteret të cilat pagat minimale i bëjnë efikase në mbrojtjen sociale, derisa njëkohësisht kontribuojnë në zhvillimin ekonomik e social.

mundësuar absorbimin e punëtorëve në sektorët me paga të ulëta siç është blegtoaria, hotelieria, dhe punëtorët shtëpiakë, në një ekonomi tejet të fragmentuar për shkak të dekadave të diskriminimit racor. Në një numër shtetesh në Azi, rregulloret e pagës minimale janë nxjerrë me sukses si përgjigje ndaj shkeljeve të të drejtave themelore të punëtorëve, sidomos në sektorin e tekstilit (ILO, 2012). Përmes analizës ekonometrike, Belser & Rani (2011) gjithashtu theksojnë se kur kontrollohen të gjitha karakteristikat personale, marrja e pagës minimale zvogëlon probabilitetin e të qenët i varfër për 10%. Ndikimi i kësaj page është sidomos thelbësor për sektorët e bujqësisë, ata të produktivitetit të ulët, si dhe për punëtorët e rëndomtë, të karakterizuar me tejpraninë e punëtorëve me pagë të ulët. Po këta hulumtues theksojnë se pagat minimale renditen të tretat për nga rëndësia pas edukimit dhe gjeografisë sa i takon zbutjes së varfërisë.

Në ekonomitë me pabarazinë e rritur në të ardhura, pagat minimale konsiderohet se i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke e zbutur pabarazinë në të ardhura dhe duke e zvogëluar numrin e "të varfërve të punësuar". Herr, Kazaniziska & Mahnkopf-Praprotnik (2009) konsiderojnë se pagat minimale kanë ndikim në pabarazinë në të ardhura përmes shpërndarjes së të ardhurave ndërmjet kapitalit dhe punës si dhe ndërmjet grupeve të ndryshme të punëtorëve. Në BE, pagat minimale konsiderohet se gjithashtu kanë efekt pozitiv socioekonomik, meqë ato e lehtësojnë barrën e shtetesh për të paguar beneficione të mbrojtjes sociale, rrisin kërkesën private meqë punëtorët me pagë të ulët e përdorin krejt pagën për konsum, dhe kështu parandalojnë deflacionin e çmimeve. Duke u siguruar të ardhura minimale përfituesve të pagës minimale, këto paga gjithashtu kontribuojnë në paqe dhe

parandalim të trazirave sociale që dalin nga padrejtësitë sociale në shoqëritë tejet të pabarabarta (ILO, 2012).

Varësisht prej kriterëve të vendosura, paga minimale gjithashtu mund të ketë ndikim në zvogëlimin e diferencës në paga ndërmjet gjinive. Futja e pagës minimale të zbatimit të përgjithshëm – pra. të aplikueshme për të gjithë punëtorët me paga të ulëta pavarësisht karakteristikave të sektorit të punës - mund të jetë sidomos efikase për zvogëlimin e diferencës së pagës ndërmjet gjinive në ekonomitë ku gratë janë të tejpranishme në sektorët me paga të ulëta, apo në cep të shpërndarjes së pagës në përgjithësi (ILO, 2012).

Duke përdorur dëshmi nga Amerika Latine, Boeri, Garibaldi & Ribeiro (2010) kanë gjetur se rritja e pagës minimale ka ndikim pozitiv edhe në paga të ekonomisë joformale. Rritja e pagës minimale në sektorin formal "sinjalizon" ndryshime të pagës në ekonominë joformale, që njihet si "Efekti i vetëtimitës", duke i shtyrë punëtorët e këtij sektori të kërkojnë paga më të mëdha. Në rrethana të tilla, thonë autorët, ndërmarrjet dhe punëtorët e vetëpërzgjedhin sektorin formal apo atë joformal.

Një sërë studimesh të tjera në anën tjetër thonë se futja e pagës minimale mund të ketë efekt të pafavorshëm marginal në sasinë e punës me pagë në ekonominë formale dhe atë joformale. Nëse paga minimale caktohet shumë lart – konsiderohet se - ajo mund ta nxisë inflacionin e çmimeve, ta zvogëlojë punësimin, dhe ta shtyjë sektorin privat formal në informalitet. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme [në veçanti] nuk mund ta përballojnë atë. Në rastet kur ajo pagë është e përballueshme, rritja e kostove të punës ka ndikim negativ në konkurrueshmëri, sidomos në sektorët e dominuar nga NVM-të, apo nga ato që punësojnë përqindje më të madhe të punëtorëve me paga të vogla (ILO, 2012).

Në cilat rrethana është e domosdoshme paga minimale?

Raporti Sistemet e Pagës Minimale (2014) nga ILO-ja jep këto emërtime të pagave minimale të aplikueshme në vendet e ndryshme në botë:

- Paga minimale e zbatimit të përgjithshëm - paga minimale e aplikueshme për të gjitha apo gati të gjitha kategoritë e punëtorëve (p.sh. Mbretëria e Bashkuar, Franca);
- Pagat minimale sipas zonës gjeografike - synon në veçanti të adresojë dallimet e standardeve të jetesës dhe/ose zhvillimit ekonomik;
- Paga minimale sipas sektorit apo profesionit (p.sh. industria e tekstitit në Azi);
- Pagat minimale sipas kriterëve të tjera: gjinia, mosha, paaftësia, përkatësia etnike, etj.

Hulumtimi tregon se pagat minimale janë pothuajse politikë globale meqë gati 90% e vendeve në botë e aplikojnë atë², pavarësisht rezultateve të tregut të punës, zhvillimit ekonomik, karakteristikave ekonomike, apo nivelit të bujarisë së sistemit të tyre të mbrojtjes sociale. Siç shihet në Tabelën 1, shumica e vendeve të BE-së kanë pagë minimale. Dy dallimet më të mëdha mund të shihen kur bëhet krahasimi i tyre: 1) Niveli i mbulueshmërisë së pagës minimale: universal përmes pagave minimale nacionale apo jouniversal përmes pagave minimale sektorale/profesionale, dhe 2) Instrumentet përmes

² ILO, 2012.

të cilave caktohen pagat minimale: rregullimi statutor apo marrëveshjet kolektive (dypalëshe apo tripalëshe). Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor gjithashtu kanë politika të pagës minimale, edhe pse kriteret për përcaktimin e saj mund të dallojnë nga shteti në shtet. Ndryshe nga vendet e tjera, Kosova dhe Shqipëria gjithashtu aplikojnë pagë të zvogëluar minimale për të rinjtë ndërmjet moshës 15-24 vjet.

Tabela 1. Sistemet e ndryshme të përcaktimit të pagës minimale në Europë

	Rregullimi statutor	Marrëveshjet kolektive
Paga e vetme minimale nacionale është pragu universal i pagës	<p>Vendet perëndimore: Franca, Luksemburgu, Holanda, Irlanda, Mbretëria e Bashkuar</p> <p>Vendet jugore: Malta, Spanja, Portugalia</p> <p>Vendet lindore: Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovenia, Turqia</p>	<p>Marrëveshjet dypalëshe: Belgjika, Estonia, Greqia</p> <p>Marrëveshjet tripalëshe: Bullgaria, Polonia, Sllovakia</p>
Nuk ka prag universal të pagës por ka paga minimale sektorale apo profesionale	Qiproja	<p>Vendet nordike: Danimarka, Finlanda, Norvegjia, Suedia</p> <p>Vendet kontinentale: Austria, Gjermania, Italia, Zvicra</p>

Burimi: ILO (2012). Drejtësia sociale dhe rritja: Roli i pagës minimale

Siç shihet në Tabelën 2, vendet e Ballkanit Perëndimor dhe të BE-së përdorin kritere të ndryshme për përcaktimin e pagës minimale. Faktorët siç janë rezultatet e tregut të punës, produktiviteti e shpërndarja e pagës janë disa prej elementeve më të rëndësishme ekonomike të cilat merren parasysh, derisa ndër kriteret e standardeve sociale/të jetesës, vendet rëndom parashohin nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, CPI-në (ndryshimin e standardit të jetesës), shkallën e inflacionit, të ardhurat nga beneficionet e sigurimit social, dhe krahasimet me standardet e grupeve të tjera.

Siç shihet në tabelë, krahasimet të indikatorëve të tjerë makroekonomikë të vendeve të ndryshme nuk flasin për ndonjë shabllon sa i përket nivelit të pagës minimale. Në shumicën e vendeve të rajonit, paga minimale caktohet ndërmjet 40% dhe 50% të pagës mesatare, pavarësisht shkallës së papunësisë, GDP-së për kokë banori dhe produktivitetit të punës. Vetëm dy shtete - Kosova dhe Shqipëria - parashohin pagë të zvogëluar minimale, por ky vendim duket të mos ketë lidhje me shkallën e papunësisë të rinjtë, e cila është 29% në Shqipëri dhe 61% në Kosovë. Këto shifra mbështesin argumentin se janë partnerët socialë dhe dialogu ata që vendosin se cilat kritere - socialë a ekonomikë - do të kenë më shumë peshë, duke caktuar kështu nivelin e pagës minimale.

Tabela 2: Paga minimale dhe indikatorët makroekonomikë në Ballkanin Perëndimor dhe vendet e përzgjedhura të BE-së³

Vendi	A ka pagë minimale?	Kriteret e përdorura për të caktuar pagën minimale	Paga minimale në euro	Paga minimale si % e pagës mesatare në vend	Paga minimale në PPS (Standardet e fuqisë blerëse)	Paga e zvogëluar minimale për punëtorët e rinj	Shkalla e papunësisë	Shkalla e papunësisë së të rinjve (15-24 vjeç)	GDP-ja për kokë banori (aktuale, në dollarë)	Produktiviteti i punës (GDP-ja për person të punësuar, PPP konstante në dollarë)
Shqipëria	PO	a) Faktorët ekonomikë: nevoja për zhvillim ekonomik, zbutja e papunësisë, dhe rritja e produktivitetit. b) Nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, duke marrë parasysh	156	47.3%	329	Këshilli i Ministrave mund ta caktojë pagën e zvogëluar minimale për punëtorët e rinj (dispozita nuk zbatohet sipas Qeverisë)	16.1%	29.2%	11108.0	25943.0

³ Këtu janë përzgjedhur Polonia, Sllovenia dhe Luksemburgu meqë ato paraqesin kufirin më të lartë të grupit të tyre (gjithsej 3) të përpiluar nga Eurostat, duke u bazuar në rangimet e BE-së dhe të Vendeve Kandidate duke përdorur pagën minimale mujore në euro. http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Minimum_wage_statistics

		nivelin e përgjithshëm të jetesës së punëtorëve në vend, të ardhurat nga beneficionet sociale, dhe standardet e jetesës së grupeve të ndryshme.								
Maqedonia	PO	N/A	214	39.6%*	458		27.9%	50.8%	13523.0	38520.0
Mali i Zi	PO	N/A	288	Jo më pak se 30% e pagës mesatare në 6 muajt e shkuar*	519		19.1%	39.5%	15054.7	45423.0
Serbia	PO	Nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre; Paga mesatare; Shkalla e papunësisë; Trendet e punësimit	234	43.7%	480		22.2%	49.5%	13594.1	26580.0

Bosnja dhe Hercegovina	PO	Indeksi i Çmimit të Konsumit për ndryshimet e standardit të jetesës; zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik; Paga mesatare; Zhvillimi i gjithëmbarshtëm ekonomik.	210	Jo më pak se 55%* e pagës mesatare			27.9%	57.5%	10429.9	34314.0
Polonia	PO	Parashikimet në GDP	791	51.3%	792		9.2%	24.0%	25261.6	55110.0
Slovenia	PO	Shkalla e inflacionit; trendet e punësimit	1923	47.6%	968		9.5%	20.8%	30402.7	62002.0
Luksemburgu	PO	Indeksi i Çmimit të Konsumatorit (CPI)	431	45.1%	1597	Nga 15 deri në 17 vjeç: 25% zbritje të pagës minimale sociale Nga 18 deri në 18 vjeç: 20% zbritje	6.1%	16.0%	98459.5	203037.0

Kosova	PO	Kostot e jetesës; shkalla e papunësisë; gjendja e përgjithshme e tregut të punës; konkurrueshmëria dhe normat e produktivitetit.	170	48.3%**	Nuk është në dispozicion		35.3%	6.1%	9113.7	Nuk është në dispozicion
--------	----	--	-----	---------	--------------------------	--	-------	------	--------	--------------------------

Burimet: Eurostati, Databanka e indikatorëve zhvillimorë të Bankës Botërore, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të Kosovës (2014)

*PPS (Standardi i Fuqisë Blerëse) si njësi valutore artificiale. Teorikisht, me një PPS mund të blihet sasia e njëjtë e mallrave dhe shërbimeve në secilin vend (Eurostati, 2016)

*Paga minimale si % e pagës mesatare të vendit në Maqedoni, Mal të Zi dhe Bosnje e Hercegovinë ka të bëjë me raportin e ILO-së, Sistemet e Pagës Minimale (2014), pra me legjislacionin e këtyre vendeve, dhe nuk përfshin përlogaritje.

**Përlogaritur nga autorët me 360 euro si pagë mesatare në Kosovë, të raportuar nga KIESA




Figura 1. Paga minimale në euro




Figura 2. Paga minimale si % e pagës mesatare në vend




Figura 3. Paga minimale në PPS (Standardet e fuqisë blerëse)

Standardet e ILO-s për vendosjen dhe fuqizimin e pagës minimale

Neni 3 i Konventës së Pagës Minimale C131 ILO (1970) përfshin një listë elementesh të standardeve të jetesës dhe të faktorëve ekonomikë të cilët duhet të përdoren si kritere për caktimin e pagës minimale. Specifikisht, konventa parasheh elemente në vijim të cilët duhet të merren parasysh kur caktohet paga minimale:

1. Nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, duke marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të pagave në vend, kostot e jetesës [dhe ndryshimet që ndodhin], të ardhurat nga beneficionet sociale, dhe standardet e jetesës së grupeve të tjera;
2. Faktorët ekonomikë, duke përfshirë edhe nevojat për zhvillim ekonomik, nivelet e produktivitetit dhe vullnetin për të arritur dhe për ruajtur shkallën e lartë të punësimit.

Kapitulli "Në ç'nivel duhet të caktohen pagat minimale" të raportit të ILO-s Drejtësia sociale dhe rritja: Roli i pagës minimale (2012), përmbledh indikatorët për caktimin e pagës minimale, burimet e të dhënave që mund të përdoren për secilin, si dhe shqyrton elementet e tjera të rëndësishme në procesin e caktimit të pagës minimale. Identifikimi i burimeve të të dhënave dhe përzgjedhja e të dhënave statistikore janë vetëm pikënisje e procesit të caktimit të pagës minimale. Raporti i cili grumbullon dëshmi nga praktikat e shumë vendeve

anëmbanë botës përdor Konventën e Pagës Minimale të vitit 1970 për t'i grupuar këta indikatorë në kategoritë në vijim:

1. Pragu i pagës minimale. Kombinimi i mallrave dhe shërbimeve i përfshirë në pragon e standardit minimal të jetesës varet nga diskutimet me hisedarët e përfshirë në dialogun politik, meqë ato mund të ndryshojnë kohë pas kohe dhe zakonisht ekzistojnë qëndrimet e ndryshme në lidhje me përmbajtjen. Pragjet ndërkombëtare apo vendore të varfërisë mund të përdoren si bazë fillestare në këtë proces. Meqë Konventa parasheh se nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre duhet të merren parasysh, Anker (2011) konsideron se është e rëndësishme të caktohet një pagë minimale e jetesës e cila merr për bazë madhësinë e familjes dhe numrin e personave që punojnë me orar të plotë në familje të cilët marrin pagë minimale. Nëse ndiqet kjo metodologji, është e rëndësishme: 1) Të identifikohen karakteristikat e një familjeje tipike me të ardhura të vogla, dhe 2) Të definohet madhësia e familjes duke përdorur normat e ekuivalencës⁴ të cilat marrin për bazë ekonominë e normave si dhe nevojat e ndryshme të konsumit të anëtarëve të familjes duke u bazuar në moshën e tyre. Formula e

$$\text{Paga minimale e jetesës} = (\text{Pragu i varfërisë} * \text{tw rriturit nw familje}) / \text{anwtarwt e familjes tw cilwt punojnw me orar tw plotw}$$

⁴ Metodologjia e shkallëve të ekuivalencës së OECD-së cakton vlerë 1 për anëtarin e parë të familjes, 0.7 për çdo anëtar shtesë dhe 0.5 për çdo fëmijë: <http://www.oecd.org/eco/growth/OECD-Note-EquivalenceScales.pdf>

Siç u tha më parë, kombinimi i mallrave dhe shërbimeve të përfshira në pagën minimale të jetesës varet në masë të madhe nga dialogu social. Gjithsesi, elementet e tjera mund të konsiderohen si bazike në vendet dhe kontekstet e ndryshme, siç është: strehimi/banimi, transporti, arsimit, shpenzimet e kujdesit shëndetësor, dhe të ngjashme. Duhet theksuar se ky model nuk ndikohet nga faktorët e tregut të punës por nga ndryshimet e çmimit, duke përfshirë edhe ndryshimet e tilla në rajonet e ndryshme.

2. Raporti ndërmjet pagës minimale dhe asaj mesatare (mesore apo mediane). Kjo metodologji merr për bazë faktorët ekonomikë, gjegjësisht shpërndarjen e pagës në vend. Në rishikimin e politikave të shumë vendeve, ILO-ja ka gjetur se vendet të cilat shfrytëzojnë këtë metodologji rëndom caktojnë pagën e tyre minimale ndërmjet 35% dhe 45% të pagës mesatare, idealisht 40%. Megjithatë, duke pasur parasysh se paga mesatare mund të mbivlerësohet ose të nënvlerësohet nga jashtë, të ardhurat mesatare janë indikator më i mirë i shpërndarjes së pagave. Rishikimi i praktikave të vendeve të ndryshme nga ILO-ja tregon se vendet të cilat e përdorin këtë indikator rëndom e kalkulojnë pagën minimale ndërmjet 50% dhe 60% të pagës mesatare. Raporti sugjeron të merren parasysh dy faktorë në rast të shfrytëzimit të kësaj metodologjie: 1) Përdorimi i rezultateve të fundit dhe i të dhënave të AFP-së, dhe 2) Përlllogaritja

e pagave për orë⁵ dhe muaj pune (për të ditur diferencën e numrit të orëve të punuara).

3. Numri i punëtorëve të prekur drejtpërdrejt nga paga minimale, dhe ndikimi në koston totale të pagës për shtetin. Kjo shifër varet nga numri i punëtorëve të prekur si dhe nga rritja e pagës mesatare si rezultat i futjes/rritjes së pagës minimale. Ndikimi i rritjes së pagës në çmime pastaj do të varet nga produktiviteti i punës dhe nga pjesëmarrja e punës në koston totale të prodhimit ku janë më të përqendruar punëtorët me pagë minimale.

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë në procesin e caktimit të pagës minimale - vendosjes së standardit minimal të jetesës dhe intervenimit në tregun e punës - është më se e rëndësishme që qeveritë të marrin vendim pas konsultimeve gjithëpërfshirëse dhe bisedimeve me partnerët socialë. Edhe pse dëshmitë janë shumë të rëndësishme në këtë proces, idealisht, partnerët socialë do të bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të indikatorëve të cilat do të përdoren dhe do të vendosin cili është më i rëndësishëm. Konventa e Pagës Minimale e vitit 1970 gjithashtu sugjeron se paga minimale caktohet përmes përfshirjes së qeverive, partnerëve socialë, si dhe ekspertëve të pavarur.

Rekomandimi për Caktimin e Pagës Minimale (1970) sugjeron se konsultimet janë posaçërisht të rëndësishme për:

⁵ Llogaritet duke i pjestuar fitimet me numrin e orëve të punuara (ILO, 2012).

- Përzgjedhjen e kritereve për të caktuar pagën minimale;
- Vendosjen e normës (normave) të pagës minimale;
- Vendosjen e afateve dhe modaliteteve për ndryshime;
- Diskutimin e problemeve të zbatimit dhe të politikave/legjislacionit [dhe përfshirjen e tyre në sistem për rishikim].

Derisa Rekomandimi trajton ndryshimet periodike në një nen të posaçëm si domosdoshmëri për të pasqyruar ndryshimet e kostove të jetesës dhe të rrethanave ekonomike, ai gjithashtu thekson rëndësinë e "instalimit" të mekanizmave zbatues të politikës së pagës minimale:

- Duke siguruar kapacitete të mjaftueshme për zbatimin e pagës minimale;
- Duke parashikuar dhe shqiptuar dënime për dispozita që kanë të bëjnë me pagat minimale;
- Duke thjeshtësuar dispozitat ligjore për t'u mundësuar punëtorëve t'i ushtrojnë të drejtat e tyre për pagën minimale, duke përfshirë të drejtën për kompensimin e shumës e cila nuk u është paguar.

PAGA MINIMALE NË KOSOVË

Dispozitat ligjore

Kosova ka vendosur pagë minimale, të detyrueshme ligjërisht, në vitin 2011. Paga standarde minimale mujore u caktua 170 euro (bruto), me një pagë të zvogëluar minimale 130 euro (bruto) për punëtorët nën moshën 35-vjeçare. Paga minimale i referohet punës me orar të plotë, me gjithsej 174 orë në muaj. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2013 për punën me orar të pjesshëm, pra për punën me më pak se 174 orë pune, duhet aplikuar paga minimale për orë pune (0.98 për orë pune për punëtorët e moshës 35-65 vjeç, dhe 0.78 për punëtorët nën moshën 35 vjeç). Paga minimale nuk është e obligueshme për kompensim (pagesa kur i punësuari është në pushim zyrtar, pushim vjetor, kur merr pjesë në programe trajnimi) si dhe gjatë punës provuese.

Duke u bazuar në diskutimet e Këshillit Ekonomik Social me përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëtorëve, nuk ka dëshmi që flet për formulën e cila është aplikuar për caktimin e pagës minimale aktuale. Përshtypja e përgjithshme është se ajo u vendos në mënyrë arbitrare nga qeveria. Sipas Ligjit të Punës, paga minimale mund të caktohet nga marrëveshjet kolektive në nivel dege apo ndërmarrjeje, por ajo nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale nacionale.

Siç parashihet me këtë Ligj (Neni 57), paga minimale duhet të caktohet në bazë të faktorëve në vijim: kostot e shpenzimeve të jetesës; shkallës së papunësisë; kushtet e përgjithshme të tregut të punës; dhe, niveli i gjithëmbarshtëm i

konkurueshmërisë dhe produktivitetit në vend. Neni 61 i Marrëveshjes Kolektive specifikon po këto kritere për caktimin e pagës minimale, duke përfshirë, e duke theksuar më shumë, koston e jetesës (kriteret përfshinë: koston e jetesës; nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre; standardet e jetesës së punëtorëve në Kosovë; si dhe nivelin e zhvillimit ekonomik).

Raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar i majit të vitit 2013 (IMF, 2013) thotë se kriteret për caktimin e pagës minimale nuk ishin caktuar në mënyrë koncize dhe se nevojitet trajtim më i bazuar në rregulla. Pas kësaj kritike, po këtë vit MMF-ja vendosi të ashtuquajturën kornizë të bazuar në rregulla për përcaktimin e niveleve të pagës minimale, të përfshirë në Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2013 për Kriteret dhe Procedurën e Përcaktimit të Pagës Minimale, të nxjerrë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në gusht të vitit 2013 (IMF, 2103)

Ligji i Punës (Neni 57) e obligon qeverinë ta përcaktojë pagën minimale në fund të çdo viti kalendarik. Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.09 /2013, paga minimale mund të rritet nëse plotësohen dy kushte: i pari, nëse norma e gjithëmbarshme e CPI-së (ndryshimi mesatar gjatë 12 muajve, tetor-tetor) e publikuar nga ASK-ja rritet për më shumë se 2%; dhe i dyti, nëse norma efektive reale e këmbimit (gjatë 12 muajve) e publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës është më e ulët se 0.5%.

Formula për rritjen e nivelit të pagës minimale për çdo kategori të grupmoshës është si vijon:

$$\text{Norma e Rritjes së Pagës Minimale} = 0.5 * \text{përqindja e ndryshimit të CPI-së} + 0,5 * \text{përqindja e ndryshimit të pagës minimale në sektorin privat}$$

Për ta llogaritur rritjen në euro për dy grupe punëtorësh, norma e rritjes duhet të shumëzohet me pagën minimale (për punëtorët nën moshën 35 vjeç + paga minimale aktuale e punëtorëve mbi moshën 35 vjeç). Udhëzimi Administrativ specifikon se duhen përdorur indikatorët dhe burimet në vijim për t'i llogaritur këto formula: 1. Paga mesatare e sektorit privat, sipas deklaratave në Administratën Tatimore të Kosovës; 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit, i pjestuar me komponentë të COICOP-së⁶, i publikuar nga Agjencia Statistike e Kosovës; dhe 3. Norma Reale Efektive e Këmbimit, e publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ thotë se formula për përcaktimin e pagës minimale mund të rishikohet çdo tre vjet, duke u bazuar në dialogun social me hisedarët dhe më një analizë të thuktë të kushteve të tregut të punës.

⁶ Kategoritë e produktit ushqimor dhe joushqimor i përdorur në Anketën e Buxhetit të Familjes.

PAGA MINIMALE NË KOSOVË NË

KONTEKST

Duke u bazuar në diskutimet me Sekretariatit e Këshillit Ekonomik Social, nuk ka dokument mbështetës që shpjegon metodologjinë e aplikuar për përcaktimin e pagës minimale aktuale, të vendosur në vitin 2011. Edhe pse Këshilli Ekonomik Social në atë kohë ka propozuar që paga minimale të jetë 50-65% e pagës mesatare, qeveria arbitrarisht ka përcaktuar pagën minimale (megjithëse në Vendim thuhet se niveli i pagës minimale u përcaktua pas propozimit nga KES-i). Krahasimi ndërmjet pagës minimale mesatare (170 euro) dhe pagës mesatare në Kosovë (354) tregon se paga minimale është 48.3% e pagës mesatare. Krahasimet me pagën mediane nuk mund të bëhen sepse AFP-ja grumbullon të dhëna mbi pagën përmes kategorive të pagave. Rezultatet e pagave neto të AFP-së (2014) tregojnë se paga minimale marrin ndërmjet 2.1% dhe 8.6% të burrave të punësuar dhe ndërmjet 2.6% dhe 11.4% të grave të punësuar. Këto shifra flasin për dy fakte të rëndësishme: 1. Se përqindja e punëtorëve që paguhen më pak se paga minimale është e vogël, dhe 2. Se një përqindje më e madhe e grave shfaqet në cep të shpërndarjes së pagës, dhe rrjedhimisht paga minimale mund të ketë ndikim pozitiv në zvogëlimin e diferencës së pagës ndërmjet gjinive.

Tabela 3: Pagat neto sipas gjinisë

Kategoritë e pagave (euro)	Burra	Gra
0-100	0.9%	1.0%
101-150	1.2%	1.6%
151-200	6.5%	8.8%
Gjithsej 0-200	8.6%	11.4%

Burimi: ASK AFP (2014)

Klasifikimi i të dhënave sipas aktivitetit ekonomik lë të kuptohet se pagat minimale kanë më shumë gjasa t'i prekin sektorët në vijim: bujqësinë, aktivitetet e shërbimeve të tjera, hotelierinë dhe akomodimin, si dhe sektorin e patundshmërive dhe të qiradhënies, si rezultat i pagave që ata sektorë japin. Klasifikimi i përqindjes së të punësuarve që përdorin kodet NACE dhe pagat bruto të këtyre të punësuarve tregojnë se: 18% e punëtorëve në bujqësi, pylltari dhe peshkatori marrin prej më pak se 50 deri në 150 euro neto, pas të cilëve vinë gati 7% e të punësuarve në shërbime të akomodimit dhe ushqimit; 16% në aktivitetet e patundshmërive; dhe 11% e të punësuarve në sektorin e shërbimeve të tjera (AKS, kalkulimet vetanake duke përdorur të dhënat e AFP-së së vitit 2014).

Krahasimi i vlerës së pagës minimale me shumat e skemave të ndryshme të sistemit të mbrojtjes sociale tregon që paga minimale është më e lartë se shumica e skemave: të gjitha skemat e pensioneve me përjashtim të asaj të

Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe madje më e madhe se Ndihma Sociale për familjet me më shumë se 15 fëmijë (120 euro). Krahasuar me beneficionet për familjet e dëshmorëve dhe të invalidëve të luftës (ku hyn gjithashtu pagesa për kujdestarët e invalidëve të luftës), paga minimale është në mes, varësisht prej numrit të anëtarëve të familjes dhe kategorisë. Duhet theksuar se përkundër dispozitave se skemat duhen përshtatur me standardet e jetesës në baza të rregullta, vjetore (më së shpeshti duke përdorur CPI-në), shumica e beneficioneve, sidomos ato të Ndihmës Sociale, kanë mbetur të njëjta që nga fillimi i aplikimit të tyre. Gjithashtu, ndryshe nga shumica e skemave që bazohen në standardet e jetesës, skema e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është e vetmja skemë e cila bazohet në paga minimale, andaj çdo vendim për përshtatjen e saj duhet të marrë parasysh implikimet buxhetore për këtë skemë, duke pasur parasysh se përfituesit e saj parashihen ta tejkalojnë shifrën prej 20,000 personave. (SHËNIM: Përkundër pritjeve të vet qeverisë, raporti i fundit i miratuar në njërin prej takimeve qeveritare përmend shifrën 46,230).

Tabela 4: Skemat e mbrojtjes sociale në Kosovë

Skema e mbrojtjes sociale	Shuma mujore
Bazike (pensionimi minimal) - të gjithë qytetarët e Kosovës mbi moshën 65-vjeçare	75 euro
Katëgoria e dytë - pensionet kontributpaguese (65-vjeçarë të cilët kanë paguar kontributin në Skemën Pensionale të Kosovës)	145 euro
Pensionet për të rriturit me paaftësi të përhershme (të moshës 18-65 vjeç)	75 euro
Pensionet e (minierës së) Trepçës (Ligji Nr. 04-L-31)	/
Pensionet për Trupat Mbrojtëse të Kosovës	/
Pensionet për Forcat e Sigurisë së Kosovës (Ligji Nr. 04/084)	40% e pagës bazike bruto, me 2 pikë rritjeje çdo vit derisa të arrijë 60% të pagës bruto
Kompensimi për të verbërit (Ligji Nr. 04/L-092)	
Familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (duke përfshirë edhe një pagë për kujdestarët e invalidëve të luftës)	50.1 (për kujdestarët e personit me më shumë se 80% të invaliditetit trupor) - 672.2 për familjet (me më shumë se 4 anëtarë) e dëshmorëve dhe ushtarëve të zhdukur të UÇK-së
Veteranët e luftës të UÇK-së	Bazuar në pagën minimale (aktualisht 170 euro)
Mbështetja materiale për fëmijët me paaftësi të përhershme (deri në moshën 18-vjeçare)	100 euro
Skema e Ndhmës Sociale (synon zbutjen e varfërisë)	40 euro për familjet me një anëtar - 120 euro për familjet me 15 anëtarë

Edhe pse kërkohet me ligj, nuk ka dokument zyrtar që dëshmon se metodologjia e përdorur për përcaktimin e pagës minimale i ka marrë parasysh kushtet e jetesës në Kosovë. Në përpjekje për ta matur përshtatshmërinë e Skemës së Mbrojtjes Sociale në Kosovë, duke përdorur metodologjinë e varfërisë si dhe të dhënat e HBS-së (2012), UNDP-ja në Kosovë ka përdorur tri metodologji për ta llogaritur standardin minimal të jetesës (duke marrë për bazë ekonomitë e shkallës dhe strukturën e familjeve);

1. Metodologjia 1: Shporta minimale e ushqimit e vitit 2002 me çmimet e vitit 2012
2. Metodologjia 2: Shporta minimale e ushqimit e vitit 2002 me çmimet vjetore të ushqimit të përshtatura me CPI-në
3. Metodologjia 3: Konsumi mesatar i ushqimit i familjeve në vitin 2012 (që gjithashtu pasqyron ndryshimet në përbërjen e shportës së ushqimit).

Rezultatet tregojnë se vërtet ka pasur rritje të kostove minimale të jetesës në Kosovë, dhe se kostoja që dikur ishte 40 euro tani sillet ndërmjet 63 dhe 74 euro për një familje njëanëtarëshe, varësisht nga metodologjia e përdorur. Nëse një familje 6-anëtarëshe (4 të rritur dhe 2 fëmijë) konsiderohet si "familje model/përfaqësuese" për fituesit e pagës minimale ku vetëm një anëtar i familjes punën me orar të plotë, llogaritjet tregojnë se paga minimale pasqyron

varfërinë e skajshme (të ushqimit) në muaj gjatë viteve 2003-2004, derisa kostot minimale të jetesës për një familje të tillë silleshin ndërmjet 225 dhe 267 euro në vitin 2012, ku ishin marrë parasysh edhe ndryshimet e çmimeve të ushqimit.

Tabela 5. Shumat mujore të Ndihmës Sociale (2012), sipas madhësisë dhe përbërjes së familjes, të përshtatura me çmimet dhe me përbërjen e shportës së ushqimit

Familja madhësia	Të rritur	Fëmijë	Vkera e pragut të skajshëm të varfërisë (së ushqimit) në muaj (2002-2003)	Shumat standarde mujore bruto plus shtesa për fëmijë, nga tetori i vitit 2017*	Metodologjia 1: sasi të çmimit e vitit 2002, vitit 2012	Metodologjia 2: sasi të çmimit vjetore të ushqimit të përshtatura me CPI-në	Metodologjia 3: shporta e minimale duke përdorur të dhënat e HBS-së 2012
1	1	0	47 euro	40 euro	69 euro	63 euro	74 euro
2	1	1	72 euro	60 euro	104 euro	95 euro	113 euro
	2	0	80 euro	55 euro	115 euro	105 euro	125 euro

3	1	2	94 euro	70 euro	136 euro	124 euro	148 euro
	2	1	101 euro	65 euro	147 euro	134 euro	159 euro
	3	0	108 euro	60 euro	156 euro	143 euro	169 euro
4	1	3	115 euro	80 euro	166 euro	151 euro	180 euro
	2	2	121 euro	75 euro	176 euro	160 euro	190 euro
	3	1	128 euro	70 euro	185 euro	169 euro	200 euro
	4	0	134 euro	65 euro	194 euro	177 euro	210 euro
5	1	4	134 euro	90 euro	194 euro	177 euro	210 euro
	2	3	140 euro	85 euro	203 euro	185 euro	220 euro
	3	2	147 euro	80 euro	212 euro	193 euro	229 euro
	4	1	153 euro	75 euro	221 euro	201 euro	239 euro
	5	0	159 euro	70 euro	229 euro	209 euro	248 euro

6	2	4	159 euro	95 euro	229 euro	209 euro	248 euro
	3	3	165 euro	90 euro	238 euro	217 euro	258 euro
	4	2	170 euro	85 euro	246 euro	225 euro	267 euro
	5	1	176 euro	80 euro	255 euro	232 euro	276 euro
	6	0	182 euro	75 euro	263 euro	240 euro	285 euro

Burimi: UNDP Kosovë. Vlera reale e Ndhmës Sociale: Vlerësimi i përshtatshëm të Skemës së

Ndhmës Sociale në Kosovë

RREGULLIMET E PAGËS MINIMALE: PARTNERËT SOCIALË

Edhe pse obligohet me legjislacion, paga minimale nuk është rishikuar që nga aplikimi i saj në vitin 2011. Në vitin 2013 KES-i ka kërkuar nga Komisioni për Financa, Ekonomi dhe Privatizim të merret me pagën minimale këtë vit. Duke u bazuar në indikatorët e tregut të punës, normën efektive reale të këmbimit dhe pagat minimale në rajon, Komisioni ka vlerësuar se paga minimale do të rritej vetëm për 5 euro.

KES konsideron se nëse merren parasysh kostot e jetesës në Kosovë, paga minimale aktuale është e vogël. Sipas Sekretarit të KES-it, Këshilli është pajtuar të propozojë pagën minimale në nivelin 60% të pagës mesatare, derisa sipas BSPK-së, KES-i do të propozojë pagën minimale e cila është baraz me 70-75% të pagës mesatare, por u duk sikur ata gjithashtu do të pajtohen me propozimin prej 60% të pagës mesatare.

Sipas BSPK-së, për të siguruar se çdo punëtor mund të sigurojë standardin minimal të jetesës, paga neto minimale duhet të jetë ndërmjet 210-230 euro. Megjithatë, nuk u tha nëse llogaritjet do të bëhen duke u bazuar në pagën mesatare nacionale (pra, duke përfshirë edhe sektorin publik edhe atë privat) apo nëse do të merret për bazë vetëm paga mesatare në sektorin privat. Rasti i dytë do të ishte më i përshtatshëm, duke u nisur nga fakti se paga minimale do të ndikojë vetëm në sektorin privat. Kjo pasi që në sektorin publik konsiderohet se pagat janë më të mëdha se paga e synuar minimale. Të dhënat e ASK-së tregojnë se paga mesatare në Kosovë në vitin 2014 ka qenë 352 euro

(ASK, 2015). Në rast se të gjithë partnerët pajtohen ta caktojnë pagën minimale në 60% të pagës mesatare, duke aplikuar pagën mesatare të vitit 2014, paga minimale do të rritej në 210 euro, duke shënuar një rritje prej 40 euro.

Sipas Odës Ekonomike Amerikane (e cila nuk është pjesë e KES-it), duke marrë parasysh rrethanat ekonomike aktuale dhe indikatorët e tregut të punës, tregu i punës duhet të jetë shumë fleksibil, dhe rrjedhimisht nuk duhet të ketë fare pagë minimale. Nëse paga minimale mbetet e aplikueshme, propozimi i Odës Ekonomike Amerikane është që ajo të mos rritet më tutje. Rritja e pagës minimale do ta rriste punën joformale, e cila më tej i përkeqëson indikatorët e tregut të punës dhe gjithashtu e përkeqëson pozitën e të punësuarve.

Edhe pse BSPK-ja propozon rritje të pagës minimale, ata gjithashtu janë të vetëdijshëm për kostot potenciale të cilat do t'i kishte kjo rritje në buxhetin e Kosovës. Kompensimi për veteranët e luftës është i caktuar në nivelin e pagës minimale, që nënkupton se me rritjen e pagës minimale qeveria do të obligohet automatikisht t'i rrisë kompensimet për veteranët e luftës. Kjo do të përkthehej në kosto shtesë për këtë kategori në vlerë 10 milionë euro (aktualisht janë rreth 46,230 veteranë edhe pse nuk janë konfirmuar zyrtarisht, nëse merret rritja e pagës në 210 euro, pra 40 euro më shumë * 20,000 veteranë = rreth 1 milionë euro shtesë në muaj).

Ekziston një pajtim i përgjithshëm se kategorizimi i pagave minimale sipas moshës së të punësuarve është diskriminues, andaj edhe duhet të hiqet. Propozimi është të aplikohet një pagë minimale uniforme për të gjithë. Nga të gjitha diskutimet, u theksua se sektorët të cilët kanë më shumë gjasa të

ndikohen nga paga aktuale dhe paga e rritur minimale janë: sektori i ndërtimit, sektori i shërbimeve (pastrim, sigurim, dhe biznese të mirëmbajtjes), i hotelierisë si dhe sektori tregtar.

Anëtarët e KES-it kanë theksuar në veçanti nevojën për të pasur një formë të definuar në mënyrë transparente për përcaktimin e pagës minimale. Ashtu siç është tash, Udhëzimin Administrativ nuk është në linjë me Ligjin e Punës.

REKOMANDIMET

- Meqenëse nuk ka dokumente apo raporte zyrtare që tregojnë për metodologjinë mbi të cilën bazohet paga minimale, është shumë e rëndësishme të shikohen të dhënat dhe burimet e ndryshme në dispozicion për t'i shërbyer ndryshimit të formulës për përcaktimin e pagës minimale. Për ta lehtësuar si dhe për ta informuar dialogun e politikave sociale, grumbullimi i të dhënave është tejet i rëndësishëm. Në këtë aspekt:
 - Duhet definuar pragu minimal i pagës. Për këtë qëllim, Anketa e Buxhetit të Familjes e AKS-së mund të përdoret për të llogaritur prahun nacional të varfërisë (duke marrë parasysh CPI-në specifike për produkte) dhe mbase edhe duke ndryshuar përmbajtjen e shportës për të përfshirë produkte të tjera përveç ushqimit (p.sh. qira, transport, kujdes shëndetësor, arsim) duke u bazuar në dialogun me partnerët socialë. Të dhënat e ABF-së gjithashtu duhen përdorur për të pasur një pasqyrë të karakteristikave të familjeve të përfituesve të pagave të vogla për të llogaritur formulën për këtë indikator si dhe për të gjetur se cila strukturë e familjes i përfaqëson ato me paga të vogla. Siç u pa në pjesën paraprake, shporta minimale e ushqimit për një familje "tipike/model" në vitin 2012 (me 4 të rritur dhe 2 fëmijë) ishte 225 euro, 32% më e lartë se paga minimale në Kosovë;

- o Duke përdorur të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës për të llogaritur pagën mesatare, dalim me rezultate të njëanshme, sepse regjistri përfshin vetëm punëtorë formalë, të regjistruar e të raportuar të sektorit privat. Duke marrë parasysh madhësinë e sektorit joformal në Kosovë - 34% deri në 37%⁷ - është tejet e rëndësishme që këto paga gjithashtu të përdoren për të përlogaritur pagën mediane dhe mesatare, sepse edhe ato janë pjesë e shpërndarjes së pagës në Kosovë. Andaj, rekomandohet që në vend të këtyre të përdoren të dhënat e AFP-së për paga. Megjithatë, pasi që AFP-ja mbledh të dhëna mbi pagën vetëm në bazë të shtrirjes së pagave - p.sh. 50-100 euro, 100-150 euro – duhet bërë përpjekje për ta ndryshuar metodologjinë dhe për t'i regjistruar pagat si variabël e vazhdueshme. Në atë rast mund të përdoret "standardi/mesatarja" e vendeve ekzistuese, 35%, 40% dhe 45% të pagës mesatare dhe sidomos 50-60% të pagës mediane (si indikator më i saktë/më pak i njëanshëm i shpërndarjes së pagës);
- o Informacionet duhen grumbulluar në bazë të pagës minimale ekzistuese dhe ndikimet e saj në kostot e tregut (pra, kostot e prodhimit të sektorit privat), pagës minimale, dhe

⁷ Vlerësimi i Institutit Riinvest (2014) për madhësinë e sektorit joformal duke përdorur dy metodologji: evazionin fiskal të ndërmarrjeve, dhe përqindjen e punëtorëve të raportuar tek autoritetet e ATK-së.

shpërndarjes së pagës. Dëshmi të pengesave në implementimin e politikës së pagës minimale gjithashtu do të mbledhen, duke marrë parasysh se masat zbatuese janë po aq të rëndësishme sa ato të përcaktimit të pagës;

- Metodologjia duhet të specifikojë qartë nëse paga minimale (duke përfshirë edhe pagën e zvogëluar për të rinjtë) është neto apo bruto, si dhe nëse ajo bazohet në pagën mesatare neto apo bruto. Gjithashtu duhet të specifikojë nëse bazohet në shpërndarjen e pagës tek publiku, apo në shpërndarjen në sektorin privat, apo të dyjat;
- Metodologjia duhet të specifikojë peshën e çdo indikatorit në përlogaritjen e pagës minimale. Gjithashtu, duhet qartësuar se cilat kritere të tjera do të përdoren në përcaktimin e pagës minimale - shkalla e papunësisë, niveli i zhvillimit ekonomik, etj. si do të maten këto, cilat janë burimet e të dhënave si dhe cila është rëndësia/pesha e tyre në përcaktimin e pagës minimale;
- Formula e përshtatjeve dhe e shpeshtësisë gjithashtu duhet specifikuar qartë. Në këtë aspekt, është tejet e rëndësishme që të merren parasysh implikimet buxhetore të Skemës së Veteranëve të Luftës, duke pasur parasysh se ajo përdoret si bazë për përcaktimin e nivelit të beneficionit të kësaj skeme. Një llogaritje e thjeshtë e rritjes së pagës minimale nga 170 euro në standardet minimale të jetesës, 225 euro në vitin 2012 nëse merret totali prej 20,000 (Shënim: shih

komentin paraprak!) përfituesve dhe nëse shpërfillen kostot administrative, dalim te një rritje prej 1,1 milionë euro (nga 3,4 milionë euro në 4,5 milionë euro) për Buxhetin e Kosovës.

- Kriteret e ndryshme të fuqizimit të parapara me Rekomandimin për Përcaktimin e Pagës Minimale (1970) duhen paraparë për implementimin efektiv të politikës;
- Përpjekjet më të gjithëmbarshme, sektorale duhen ndërmarrë për avancimin e dialogur social ndërmjet hisedarëve të ndryshëm për të siguruar përfaqësimin e nevojave të grupeve të ndryshme me qëllim të përcaktimit të shkallës së pagës minimale. Konsultimet për këtë hulumtim kanë treguar se numri i hisedarëve të përfshirë në proces ishte mjaft i kufizuar, edhe pse dialogu social është thelbësor për këtë proces;
- Edhe pse Këshilli Ekonomik Social ka përshtypjen se paga minimale e të rinjve duhet të hiqet për të shmangur trajtimin e padrejtë në tregun e punës, vlerësimet e praktikave, sidomos në vendet e BE-së, duhen zhvilluar para se të nisë çfarëdo debati mbi këtë temë. Shumë vende në BE, dukë përfshirë Republikën Çeke, Holandën dhe Spanjën, përdorin madje shkallë të shumëfishta për grupmosha të ndryshme të të rinjve. Edhe disa argumente që duhen pasur parasysh kundrejt pagës minimale universale janë shkallët e ulëta të produktivitetit të punëtorëve të rinj, preferencat e punëdhënësve për punëtorë më të moshuar nëse pagat minimale vendosen në nivel të njëjtë, si dhe nxitja

e punëtorëve të rinj ta braktisin shkollimin për shkak të të ardhurave të larta kur merren parasysh aftësitë e tyre dhe përvoja e tyre e punës (ILO, 2014).

Duke u nisur nga standardet ILO-s dhe praktikat në mbarë botën për përcaktimin e pagës minimale, pjesa në vijim përdor të dhëna në dispozicion për të simuluar pagën minimale duke përdorur kriteret e ndryshme dhe implikimet financiare të secilës në buxhetin e Kosovës. Meqë vetëm Skema e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës bazohet në pagën minimale, barra financiare e skemës në buxhetin e Kosovës mund të përllogaritet duke përdorur vetëm shifra të përfituesve të kësaj skeme.

- **Pragu minimal i pagës.** Siç u pa në pjesën paraprake, duke përdorur metodologjinë e Bankës Botërore për përllogaritjen e varfërisë në Kosovë - shporta minimale e ushqimit (2012) për familjen model/tipike prej 6 anëtarëve (4 të rritur dhe 2 fëmijë), dhe CPI-në të kategorizuar për ushqim - UNDP-ja në Kosovë ka gjetur se standardi minimal i jetesës për këto familje është 225 euro⁸. Shumëzimi i kësaj shifre me numrin e paraashikuar të përfituesve të Skemës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (46,230) jep shifrën prej 10,4

⁸ Kjo metodologji preferohet meqë ajo përdor përbërjen e shpirtës minimale të ushqimit (që ende përdoret nga ASK-ja për llogaritje të varfërisë) dhe shifrat vjetore të CPI-së sipas kategorisë së artikujve ushqimorë.


milionë euro shpenzime për buxhetin e Kosovës nëse këto shifra përdoren për të përcaktuar pagën minimale.

- Megjithatë, duhet vënë në pah se shifra 225 euro merr parasysh vetëm ushqimin minimal për familjen e kësaj madhësie dhe strukturën e familjes. Nëse dialogu social kërkon që të përdoren elemente shtesë në përllogaritje, siç është banimi, transporti e veshëmbathja, nevojiten kalkulimet shtesë për shpenzimet e familjes model, dhe që kostot shtesë t'i shtohen shumës prej 225 euro në muaj;
 - Familja tipike/model 6-anëtarëshe e përdorur në përllogaritjen e varfërisë bazohet në demografinë 2002-2003 dhe nuk merr parasysh statusin e punës së anëtarëve të familjes. Nevojitet analizë shtesë e Anketës së Buxhetit të Familjes për të përcaktuar karakteristikat demografike të familjes model/tipike me një anëtar të punësuar;
 - Shporta minimale e ushqimit e një familjeje tipike/model duhet llogaritur përsëri për të marrë për bazë ndryshimet eventuale të saj përgjatë kohës.
- **Raporti ndërmjet pagës minimale dhe asaj mesatare (mesore apo mediane).** Duke u nisur nga fakti se të dhënat e AFP-së në Kosovë grumbullojnë informacione për paga përmes kategorive të pagave, pikat e mesme dhe pesha e çdo kategorie pagash duhet përdorur për të përllogaritur pagën minimale si përqindje të pagës mesatare. Duke

përdorur të dhënat e AFP-së mbi pagat neto sipas gjinisë si dhe kriterin e ILO-s prej 35%, 40% dhe 45% të pagës mesatare, grafikoni i mëposhtëm tregon se paga minimale sillet prej 130 deri në 167 euro nëse nuk merret parasysh shpërndarja e pagës, derisa nëse ajo merret parasysh dalim te shifrat 124, 142 apo 159 euro pagë minimale neto në muaj.

- Duhet theksuar se ndryshe nga legjislacioni aktual, këto shifra përbëjnë pagën minimale neto;
- Duke marrë parasysh se paga mediane është indikator më i saktë i shpërndarjes së pagës, dhe se përlogaritja e saj është e pamundur me shtrirjet e tanishme të pagave, rekomandohet që ASK-ja të grumbullojë të dhëna për paga si variabël të vazhdueshme në vend të shtrirjeve të pagave;
- Meqë ato grumbullohen përmes AFP-së, këto shifra përfshijnë edhe sektorin publik edhe atë privat, si dhe ekonominë formale dhe atë joformale. Edhe pse këto të dhëna favorizohen kundrejt të dhënave të ATK-së, duhen përdorur shifrat vetëm prej sektorit privat për të arritur sa më shumë saktësi.

Figura nr. 4. Paga minimale e peshuar dhe e papeshuar si % e pagës mesatare neto



Burimi: ASK 2016. Rezultatet e Fuqisë Punëtore të Kosovës 2015

*Shënim: Shifrat e peshuara të llogaritura duke përdorur mesataren (354.4 euro) të pagës neto të burrave dhe (351 euro) të pagës neto të grave.

Duke përdorur këto shifra me numrin e parashikuar të përfituesve të Skemës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (46,230), shohim se kostot për buxhetin e Kosovës do të sillleshin nga 6 deri në 7,7 milionë euro nëse paga e papeshuar mesatare neto përdoret për përcaktimin e pagës minimale, derisa nëse përdoret paga e peshuar mesatare neto shpenzimet do të sillen ndërmjet 5,7 milionë euro dhe 7,3 milionë euro në muaj.

Paga minimale si % e pagës mesatare neto	E papeshuar	E peshuar
	euro 5,993,257.20	
35% e pagës mesatare neto	euro	euro 5,734,223.58
40% e pagës mesatare neto	euro 6,849,436.80	euro 6,553,398.37
45% e pagës mesatare neto	euro 7,705,616.40	euro 7,372,573.17

- **Numri i punëtorëve të prekur drejtpërdrejt nga paga minimale, dhe ndikimi në koston totale të pagës për shtetin.** Anketa e Fuqisë

Punëtorë e ASK-së dhe burimet e tjera nuk lejojnë përlllogaritje të totalit të pagës së Kosovës e cila do të përfshinte futjen dhe ndryshimet të pagës. Megjithatë, të dhënat e AFP-së (2015) tregojnë për shpërndarjen e të punësuarve burra dhe gra përgjatë rangut të pagave neto, siç shihet në tabelën e mëposhtme. Por, përkundër numrit total të të punësuarve burra dhe gra anembanë Kosovës, duke pasur parasysh se këto shifra jepen si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik, të dhënat nuk mundësojnë përlllogaritje të pagës totale.

Net ëage bracket	Burra	Gra
(0-100 euro)	0.2%	0.3%
(101-150 euro)	1%	1.3%
(151-200 euro)	5.9%	7.2%
Total burra dhe gra që fitojnë ndërmjet (0-200 euro) në muaj	7.1%	8.8%

REFERENCAT

Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 09/2013 për Kriteret dhe Procedurën e Përcaktimit të Pagave Minimale në Republikën e Kosovës

Belser, P. & Rani, U. (2011.). Extending the coverage of minimum wages in India: Simulations from household data. Gjetet në:

http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/@ed_protect/@protrav/@travail/documents/publication/wcms_145336.pdf

Boeri, Garibaldi & Ribeiro. (April, 2010). Behind the Lighthouse Effect.

Gjetet në: <http://ftp.iza.org/dp4890.pdf>

Eurostati. 2016. Statistikat e pagës minimale. Gjetet në:

http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Minimum_wage_statistics

Herr, Kazandziska & Mahnkopf-Praprotnik. (February, 2009). The theoretical debate about minimum wages. Gjetet në: http://www.global-labour-university.org/fileadmin/GLU_Working_Papers/GLU_WP_No.6.pdf

ILO. 2014. At work but earning less: Trends in decent pay and minimum

wages for young people: http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/documents/publication/wcms_340067.pdf

ILO. 2014. Minimum Wage Systems. Gjetet në:

http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_norm/---relconf/documents/meetingdocument/wcms_235287.pdf

ILO. 2012. Social Justice and Growth: The Role of the Minimum Wage.

Gjetet në: http://www.ilo.org/actrav/info/international-journal-labour-research/WCMS_183568/lang--en/index.htm

ILO. (n.d.). C131 – Konventa për Përcaktimin e Pagës Minimale, 1970 (Nr. 131)

ILO. (n.d.). Rekomandimi për Caktimin e Pagës Minimale, 1970 (Nr. 135)

Agjencia Statistikore e Kosovës. Qershor, 2016 Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore të Kosovës, 2015 Gjetet në: <https://ask.rks.gov.net/en/lm?download=1636:results-of-the-kosovo-2015-labour-force-survey>

Agjencia Statistikore e Kosovës. Qershor, 2015 Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore të Kosovës, 2014 Gjetet në: http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2016/03/18/090224b082ff4883/1_0/Rendered/PDF/Results0of0the0labour0force0survey0.pdf

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë. 2016. Cila është paga minimale në Kosovë? Gjetet në: <http://www.invest-ks.org/en/What-is-the-average-wage-in-Kosovo>

Ligji Nr. 7961 i 12 korrikut, 1995 për Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës në Republikën e Kosovës.

Ligji i Pagës Minimale i Republikës së Maqedonisë

OECD. Çka janë shkallët e ekuivalencës? Gjetet në: <http://www.oecd.org/eco/growth/OECD-Note-EquivalenceScales.pdf>

The World Bank: World DataBank:
<http://databank.worldbank.org/data/home.aspx>

UNDP.2014. The real value of Social Assistance: An assessment of Social Assistance benefit adequacy. Gjetet në:

<http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Communications/Dokumenti%20The%20Real%20Value%20of%20Social%20Assistance%20ONLINE.pdf>

SHTOJCA

	Pika mesatare e pagës neto	Burra	Gra	Paga e peshuar mesatare neto (burra)	Paga e peshuar mesatare neto
	50 euro	0.20%	0.30%	0.1 euro	0.15 euro
	125.5 euro	1%	1.30%	1.255 euro	1.6315 euro
	175.5 euro	5.9%	7.20%	10.3545 euro	12.636 euro
	225.5 euro	12.20%	11%	27.511 euro	24.805 euro
(251-300 euro)	275.5 euro	19%	17.40%	52.345 euro	47.937 euro
(301-400 euro)	350.5 euro	30.40%	32.80%	106.552 euro	114.964 euro
(401-500 euro)	450.5 euro	21.40%	22.30%	96.407 euro	100.4615 euro
(501-600 euro)	550.5 euro	5.40%	4.40%	29.727 euro	24.805 euro
(601-800 euro)	700.5 euro	2.50%	2.20%	17.5125 euro	15.411 euro
*€801+	800 euro	2%	1.10%	16 euro	8.8 euro
	Paga e papeshuar mesatare	100%	100%	357.764 euro	351.018 euro

Burimi: ASK (2016) Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2015.

*Për këtë bracket, kemi përdorur cakun e poshtëm 801 euro për të kalkuluar mesataret e peshuara dhe të papeshuara.



SUPPORT
TO SOCIAL
PARTNERS

